



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1236/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lindon Kqira - Kandidat për Asamble Komunale (PDK) dega në Gjakovë, dhe Magdalena Kqira (PDK) dega në Gjakovë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV) dega në Gjakovë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, morri këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Lindon Kqira - Kandidat për Kuvendin Komunal në Gjakovë nga radhët e subjektit politik PDK .

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:55 nga parashtruesi i ankesës Lindon Kqira - Kandidat për Asamble Komunale ku pretendohet se, në VV 0205C, 0222C, 0224C, 0203C, 0201C, 0202X, 0204C kanë ndodhur pa drejtësi gjatë procesit të numërimit të votave, prandaj kërkojm rinumërimin e votave. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur fletlistat e kandidatëve për Asamble Komunale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga Lindon Kqira - Kandidat për Asamble Komunale (PDK) dega në Gjakovë, pretendohet se në vendvotimet VV 0205C, 0222C, 0224C, 0203C, 0201C, 0202X, 0204C janë dëmtuar, mirëpo një pretendim i tillë nuk mund të vërtetohet se është kryer një veprim i ndaluar.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë ankimorë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

